



Republika e Kosovës – Republika Kosova  
Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtresa  
Izbornni Panel za Žalbe i Predstavke

ZL.Anr.112/2017

**Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtresa (PZAP)**, në panelin e përbërë nga gjyqtarët: Hasan Shala kryesues, Fejzullah Rexhepi dhe Adnan Konushevci anëtarë, me pjesëmarrjen e zyrtares ligjore Fitore Isufi, duke vendosur përkitazi me ankesën e subjektit politik Lëvizja Vetëvendosje, me seli në Prishtinë, paraqitur kundër subjektit politik Aleanca për Ardhmërinë e Kosovës (AAK), për shkak të vendosjes së posterit në vend publik, për Zgjedhjet Lokale që do të mbahen më datë 22.10.2017, në seancën e panelit të mbajtur me 03.10.2017, mori këtë:

### V E N D I M

**Pranohet** si e bazuar ankesa e subjektit politik Lëvizja Vetëvendosje (VV), me seli në Prishtinë, ndërsa subjektit politik Aleanca për Ardhmërinë e Kosovës (AAK), me seli në Prishtinë, i shqiptohet dënimi me gjobë në vlerë prej 800,00 euro, të cilën detyrohet ta paguaj në afat prej 15 (pesëmbëdhjetë) ditëve, nga dita e pranimit të këtij vendimi nën kërcënim të përmbarimit.

### A r s y e t i m

Subjekti Politik Lëvizja Vetëvendosje (VV), me seli në Prishtinë, ka parashtruar ankesë në PZAP, më datë 02.10.2017, nga subjekti politik LVV, me të cilën pretendon se aktivistët e tyre, kanë vërejtur se në Rrugën “Selami Pulaha” në Prishtinë në hyrje të nënkalimit është vendosur poster i kandidatit për anëtarë të Kuvendit Komunal të Prishtinës, nga radhët e subjektit politik AAK, Yll Bogaj. Me këtë rast parashtruesi i ankesës thekson se subjekti politik AAK, ka bërë shkelje të dispozitës së nenit 4.1 pika b) të Rregullës Zgjedhore 11/2013 dhe nenit 3.4 të Rregullës Zgjedhore 13/2014 të KQZ-së.

Në mbështetje të pretendimeve ankimore ka bashkangjitur fotografi nga vendi ku ka ndodhur shkelja e kodit të mirësjelljes për subjekte politike, mbështetësit e tyre dhe kandidatët.

Në përgjigjen në ankesë të datës 03.10.2017, subjekti politik AAK, thekson se vendosja e posterit nuk është bërë nga ana e AAK-së, por mund të jetë bërë nga qytetar apo individ të pa identifikuar dhe pasi kanë pranuar njofimin për ankesë konfirmon se ka kontaktuar strukturat menaxhuese të fushatës, konkretisht Shtabin Zgjedhor për komunës së Prishtinës për të bërë hjekjen e posterit dhe menjëherë kanë ndërmarrë masat përmirësuese, për evitimin e shkeljes.

Përgjigjes në ankesë si provë për të dëshmuar pretendimet e tyre i kanë bashkëngjitur fotografi nga vendi ku është larguar posterit.

Paneli, pasi që shqyrtoj ankesën vlerësoi se:

## **Ankesa është e bazuar**

Paneli nga fotografitë e ofruara si provë nga parashtruesi i ankesës, e cila gjendet në shkresat e lëndës, në mënyrë të padyshimtë, ka konstatuar se posteri i kandidatit për anëtarë të Kuvendit Komunal të Prishtinës nga radhët e subjektit politik AAK, është vendosur në vend publik, veprim ky që është në kundërshtim me nenin 33, pika b), të LZP-së e cila përcakton: “*Veprimet e ndaluara nga ana e subjekteve politike gjatë fushatës zgjedhore që ndalon vendosjen e pllakateve, posterave dhe njoftimeve në apo mbi rrugët publike*”.

Duke u nisur nga gjendja e konstatuar faktike, Paneli konstaton se nga prova e ofruar shihet qartë se nga ana e subjektit politik AAK, është shkelur neni 33, pika b), të LZP-së, pasi që posteri i kandidatit për anëtarë të Kuvendit Komunal të Prishtinës nga radhët e subjektit politik AAK është vendosur në vend publik. Të cilën shkelje e ka evituar edhe vetë subjekti politik, siç shihet në fotografitë bashkangjitura përgjigjes në ankesë të datës 03.10.2017.

Paneli me rastin e vendosjes së gjobës si në dispozitiv të këtij vendimi, ka marrë parasysh rrethanat si në vijim:

- Natyra e shkeljes dhe ndikimit të mundshëm të saj në procesin zgjedhor;
- Shkallën dhe peshën e shkeljes;
- Nëse subjekti politik ka marrë pjesë në zgjedhjet e mëparshme, konsiderohet se kanë qenë të njoftuar me obligimet dhe përgjegjësit gjatë procesit të fushatës;
- Nëse subjekti politik ka bërë shkelje të ligjeve zgjedhore në fuqi në këto zgjedhje apo në zgjedhjet e mëparshme në Kosovë si dhe
- Shumën e fondeve të marra nga subjekti politik prej Buxhetit të Republikës së Kosovës, për zhvillimin e aktiviteteve të lidhura më fushatën zgjedhore.

Paneli, mori parasysh të gjitha rrethanat për rastin konkret duke pasur parasysh faktin se subjekti politik Aleanca për Ardhmërinë e Kosovës (AAK), nuk merr pjesë për herë të parë në zgjedhje dhe se të njëjtit janë të njoftuar me rregullat zgjedhore. Po ashtu si rrethanë, PZAP-i e mori edhe faktin që këtij subjekti, ia dha mundësinë për tu përgjigjur ashtu që në përgjigjen e pranuar nga ana e tyre shihet qartë se brenda afatit të caktuar kanë ndërmarrë veprime për të bërë përmirësimin e shkeljes ashtu që e kanë tërhequr posterin në vendin e palejuar, i cili veprim ka ndikuar në lartësinë e gjobës së shqiptuar si në dispozitiv të këtij vendimi me këtë gjobë paneli vlerësoi se me gjobën e shqiptuar do të ndikon që mos të përsëriten veprimet e kësaj natyre në të ardhmen.

Paneli në kuptim të nenit 120.1, pika c), dhe nenit 118.1, të LZP-së, vendosi si në dispozitiv të këtij vendimi.

### **Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtrësia**

ZL.Anr. 112/2017 më datën 03.10.2017.

**Kryesuesi i Panelit**  
**Hasan Shala**



***Këshilla Juridike: Kundër këtij vendimi nuk lejohet ankesa konform nenit 118 par. 4 të LZP-së.***